

Përshëndetje,

në përgjigje të kërkesës tuaj, ju informojmë si vijon;

Në bazë të Vendimit të KM Nr. 308, datë 21.05.2014 “Për miratimin e paketave të shërbimeveshëndetësore që do të financohen nga Fondi i Sigurimit të detyrueshëm të Kujdesit Shëndetësor nëshërbimin spitalor”, i ndryshuar, Fondi financohet paketat shëndetësore nëpërmjet institucioneveshëndetësore të kontraktuara publike dhe jo publike.

Një ndër paketat më kryesore të financuara nga Fondi është edhe Paketa e Transplantit Renal e cila ka filluar të financohet 10% nga Fondi në vitin 2015. Kjo paketë është realizuar në institucionet shëndetësore jo publike Amerikan Hospital dhe spitali Hygeia, të kontraktuara me Fondin.

Janë kryer gjithsej 157 transplante të veshkës nga vitin 2015 deri në 2023.

Krahas kësaj pakete janë realizuar edhe paketa e “Flakjes Akute të Veshkës”, për rastet të cilat kanë ndodhur dhe kanë rezultuar 11 raste.

Cmimi i transplantit është i përcaktuar në VKM.

Për të përfituar këtë paketë të sëmurët paraqiten në shërbimin e Nefrologjisë-Hemodializës në QSUT të cilët e rekomandojnë të sëmurin për transplant të veshkës. I sëmuri pas këtij hapi autorizohet nga Sektori i Regjistrimit Kombëtar të Paketave pranë DSHSU (Drejtoria e Shërbimeve Spitalore Universitare) për të kryer paketën e transplantin të veshkës në një nga institucionet shëndetësore të cilat plotësojnë kritere të realizimit të paketës sipas protokollit të paketës të miratuar nga Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale.

Kjo paketë në Shqipëri realizohet në bazë të dhuruesve familjarë, të përcaktuar në Ligjin për transplantet dhe komisionin e etikës pranë MSHMS.